Të paktën 1 (nje) mjet transporti të përshtatshëm për transport në kushte amballazhimi, të vërtetuar me dokumentacion:
 - *dokument që vërteton rregjistrimin e automjetit (leje qarkullimi)*
 - *kontrollin teknik, siguracionin e automjetit, taksa të paguara dhe licenca për transport mallrash.*

Për lotët konkurrues **“Blerje mish”** dhe **“Blerje Bulmet”** mjeti transportit duhet të jetë **frigoriferik** të përshtatshëm për transport në kushte amballazhimi,

Si dhe lejen higjeno-sanitare për mjetet e mësipërm për vitin 2018, e vlefshme për periudhën e realizimit të objektit të kontratës **për lotin konkurrues**.

7. Dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike **për lotin konkurrues**.
8. **Për artikujt: vaj, oriz, sheqer, fasule, makarona të lotit “Blerje Ushqime” dhe bukë të lotit “Blerje Bukë”** duhet të paraqiten Raport Analizat Origjinale, të lëshuara nga Laboratori i akredituar, ku të përfshihen të gjithë treguesit e përcaktuar në specifikimet teknike të dhënë në dokumentat e tenderit jo më parë se tre muaj nga dita e hapjes së ofertes.

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

Shtojca 9

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

SPECIFIKIMET TEKNIKE

Specifikimet teknike janë të detyrueshme për ofertuesit.

Mospranimi i tyre është kusht skualifikues në tender.

- PER ARTIKUJT E TE PERSHKRUARA NE LOT-e

Specifikimet teknike dhe përshkrimi i mallrave që do të prokurohen janë përgatitur nga Autoriteti kontraktor, për të përcaktuar sa më saktë dhe në mënyrë sa më të plotë objektin e prokurimit dhe për të krijuar kushte për një procedurë të paanshme dhe të hapur ndërmjet gjithë kandidatëve.

Specifikimet teknike përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit kontraktor në lidhje në cilësi, dimensionet, ambalazhimin, marketimin dhe etiketimin e mallrave që prokurohen. Emertimin e plotë, sasitë njesia e matjes, për çdo artikull janë përcaktuar saktë në tabelat bashkëngjitur që do të plotësohen nga kandidatët.

Për Lotin Nr.1 : “Blerje Ushqimore”



1.Vezet : Vezet duhet të jenë sipas standartit shtetëror 4N/ECE 42 të vitit 2001. Vezet të jenë prodhim vendi dhe të stampuara ku të dallohet qartë origjina e mallit. Të jenë të vendosura në bikurina, të ambalazhuara në kuti kartoni ku të jete etiketuar prodhuesi, data e prodhimit dhe të jenë të vulosura nga prodhuesi mbi çdo kuti. Vezet duhet të kenë një afat skandence nga data e prodhimit vetëm 15 dite. Të jenë me peshë 50 deri 70 gr.

Furnizimi do të kryhet sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktor, me mjetet e furnitorit deri në magazinat e bleresit.

2.Vaj të jete sipas standart shtetëror 203: 2003. Treguesit fiziko-kimik: Dendësia relative në 20 grade.C/ uje në 20 grde.C 0.918-0.923. Numri i refraksionit 1.461-1.468. Numri i sapunifikimit 188-194. Treguesi i jodit 118-141. Treguesi i cilesise: Ngjyra e verdhe në të lehtë. Era dhe shija karakteristike e vajit të lulëdiellit, pa erë e shije të huaj. Numri i peroksideve: Jo më shumë se 10 mek O2 aktiv / kg vaj. Numri i aciditetit: jo më shumë se 0.4 mg KOH gr vaj. Shmangia në vëllim deri në 1%. Kontaminuesit jo më shumë se : lende të patretshme 0.05%. Permbajtja e sapuneve 0.005%. Lende fluturuese, në 105 grade c 0.2. Ambalazhimi dhe etiketimi: Ambalazhimi bëhet në shishe plastike me kapacitet 1 liter. Mbi çdo ambalazh vendoset etiketa për datën e prodhimit, llojin e vajit, masën në litra, etj. Etiketimi bëhet sipas legjislacionit në fuqi.

Sheqer : duhet të jete me treguesit fiziko- kimik: Sheqer i paster 99.6%, hiri deri 0.07%, lageshtira deri në 0.16 %. Pamja: pluhur i përbërë nga kristale të imta e të njellojta. Ngjyra: i bardhë në shkelqim. Treguesit shqisor: i derdhur i thatë, me shije të embël pa erë të huaj,

perdorim te njetrajtshem, te tretet plotesisht. Amballazhimi ne pako letre 1 kg ose thase lini ose plastmasi 50 kg dhe etiketuar sipas standartit ne fuqi.

Oriz: te jete me treguesit shqisor: Pamja kokrra te shendosha, te plota, te pastra e pa myk. Ngjyra e bardhe. Era pa shije te tharte pa ere myku. Treguesit fiziko – kimik: lageshtira deri ne 15 %, kokrra te thyera deri ne 12%, lende te huaja deri ne 0.4 %, kokrra te verdha deri ne 4%. Nuk lejohen demtues. Amballazhi ne pako 1 kg, letre ose plastmasi ose ne thase lini ose plastmasi 50 kg.

Makarona : te jene me treguesit shqisor: ngjyra e bardhe ne te verdhe, pa shije te hidhur e te tharte, pa ere te huaj. Treguesit fiziko – kimik: lageshtira deri ne 13 %, aciditeti jo me shume se 0.16 %, rritja e volumit jo me pak se dy here. Nuk lejohen demtues. Mielli i stazhionuar jo me pak se 15 dite, i sigur 100%, nuk lejohen demtues. Amballazhimi: ne pako 0.5 ose 1 kg, i etiketuar sipas standartit dhe te futura ne kuti kartoni.

Salca: duhet te jete e perpunuar me baze vetem domate, prodhim vendi ose i huaj. Malli te jete i amballazhuar ne kuti llamarine 400 gr, ose 500 gr. Kutia te jete e mbyllur hermetikisht dhe e mbeshtjelle me etikete te perkthyer ne gjuhen shqipe kur malli eshte i huaj. Permbajtja te jete salce dhe kripe. Perberja e mases te jete homogjene dhe me 18 -20 % lende e thate. Nuk lejohen perberes te tjere dhe lende te huaja. Ngjyra e salces te jete e kuqe e thelle. Shija te jete e embel pa shume aciditet. Aroma te jete e kendeshme ne perputhje me aroren e domates se fresket karakteristike e llojit. Ne etikete te jete shenuar qarte firma prodhuese dhe ajo tregtuese. Kapaku te jete i mbyllur hermetikisht dhe me afatin e skadences. Nuk lejohet me afat perdorimi me shume se nje vit.

Kripa : duhet te jete e cilesise se pare e jodizuar, e amballazhuar ne pako 0.5 deri 1 kg. Pamja: mase e perhedhur dhe e perbere nga kristale te imta e te njellojta. Ngjyra: e bardhe me shkelqim. Treguesit shqisor: me shije karakteristike te kripur, pa ere te huaj, me perdorim te njetrajtshem, e treteshme plotesisht ne uje.

Reçel : kokerr, i amballazhuar me ene hermetike dhe pa papasterti, duhet te jene sipas standartit shtetëror të amballazhuara ne vazo 450 gr. me etiketim te rregullt ku te lexohet qarte prodhuesi, data e prodhimit, skadencia ku afati i skadences te jete jo me pak se nje vit nga data e furnizimit, si dhe pëmbajtja e tyre.

Miellë : Treguesit shqisorë:

1.Pamja:

Të jetë pluhur i njëtrajtshëm pa lëndë të huaja Insekte dhe dëmtues të tjerë nuk lejohen.

2.Ngjyra:

E bardhë

3.Era dhe shija:

E këndshme, karakteristike e miellit të grurit, pa erë dhe shije të huaj.

Treguesit kimik:

Në përputhje me Standartin Shtetëror Shqiptar.

Të jetë i cilësisë së parë, i stazhionuar, i amballazhuar në pako 1 kg letre, me etiketë prodhuesi dhe afat skadence të shënuar.

Rekomandime për përdorim, nëse këto ndikojnë në mënyrë të ndjeshme mbi afatet e ruajtjes së

cilësisë ose mbi vlerat e produktit ushqimorë. Këto të dhëna të jepen mbi amballazh ose mbi etiketë.

Çaj: Çaji i malit të jetë cilesia e parë në formë tufe me erë karakteristike pa lëndë të huaja.

Niseshite : Të jetë e cilësisë së parë, e stazhionuar, e amballazhuar në pako 1 kg letre, ku të shënohet:

Emërtimi i prodhuesit

Emri i produktit

Pesha neto ose vëllimi i produktit

Data e prodhimit

Data e skadimit

Kushtet e veçanta të ruajtjes

Rekomandime për përdorim, nëse këto ndikojnë në mënyrë të ndjeshme mbi afatet e ruajtjes së cilësisë ose mbi vlerat e produktit ushqimorë. Këto të dhëna të jepen mbi amballazh ose mbi etiketë.

Vaj ulliri : Treguesit shqisorë:

1.Pamja:

Lëng vajor, pa depozitime.

2.Ngjyra:

Në ngjyrë ulliri, e lehtë.

3.Era dhe shija:

E mirë, karakteristike e ullirit, pa shije dhe erë të huaj.

Treguesit kimik:

Në përputhje me Standartin Shtetëror Shqiptar.

Amballazhimi dhe etiketimi:

Vaj i ullirit do të ambalazhohet në shishe plastike ose qelqi me vëllim 1 litërshe, të mbyllur me tapë plastike me vidhëzim hermetike të kapsuluara me shirit PVC me stampën përkatëse.

Mbi çdo shishe do të vendoset etiketa në të cilën të shënohet:

- Emërtimi i plotë i mallit.
- Data e skadimit ose afati i përdorimit që do të jetë 18 muaj nga data e prodhimit dhe e furnizimit në institucion.

- 1- Te gjitha Ushqimet sipas listes te jete cilesia e I (Pare) te amballazhura me date prodhimi dhe skadimi apo me flete analize laboratorike .
- 2- Furnitori apo transportuesi te pajiset me autorizim dhe me te drejt firme kur nuk zbatohen kushte e vendosura nga institucioni.
- 3- Furnizimi me ushqimore do te kryehet sipas kerkeses apo grafikut te hartuar per kete qellim.
- 4- Kur nuk zbatohen kushtet e mesiperme dhe me 3 proces-verbale gjate vitit do te nderpritet furnizimi me firmen kontraktues.


Për Lotin Nr.2 “Blerje – Bulmeti”

Qumeshti : duhet te jete brenda standarteve shteterore dhe i certifikuar per konsum. Qumeshti te jete prodhuar brenda dites mundesisht nga mjelja e pare ne mengjes pasi dhe konsumi do te jete ditor. Qumeshti te kete karakteritikat tipike te qumeshtit i cili ka ngjyre pak te verdhe, pa perberes te huaj dhe papasterti te tjera, i kulluar dhe me perqindje yndyre deri ne 2%, aciditet 17 – 19, ngarkesa mikrobike 1 – 2 milion / 1 ml, mbetja e thate 10 – 12. Transporti do te kryhet ne ene inoksi te standartit shteteror. Furnizimi do te behet sipas kerkese ditore te Drejtorise se Sherbimit Spitalor Mat me mjetet e furnitorit. Qumeshti duhet te jete i prodhuar e grumbulluar brenda kushteve standarte higjenike te Ministrise se Bujqesise dhe Ministrise se Shendetsise. Prodhimi te jete i shoqeruar me certifikate te analizes te bere nga laborator i veterinar. Furnizimi do te kryhet sipas kerkeses se Autoritetit Kontraktor

<u>Pamja e jashtme</u>	Leng i njellojte (homogjen) , pa lende te huaja qe duken e notojne, ose bien ne fund . Me rrjedhje te njellojte dhe pa nderprerje.
<u>Ngjyra .</u>	E bardhe e njellojte me nuance te lehte te verdhe .
<u>Shija dhe era .</u>	E kendshme , lehtesisht e embel , me shije te lehte zierje, pa shije dhe ere te huaj.

TREGUESIT FIZIKO – KIMIKE

<u>Dendesia</u>	Ne 20 ° C, jo me pak se 1 .029
<u>Permbajtja e yndyres</u>	Ne perqindje ± 0.1
<u>Aciditeti</u>	Ne grade Tjorner , jo me shume se 20.
<u>Mikroorganizma patogjene</u>	Nuk lejohen



DJATHE BAXHOJE STAZHONUAR

Cmimi i ofertes qe do te paraqitet nga secili konkurent duhet te perfshije :
Furnizimi me kete artikull do te jete vetem **DJATHE I BARDHE (FETE) BAXHOJE I STAZHONUAR**

TREGUESIT CILESORE

<u>Pamja e jashtme</u>	E formuar mire, e paster e pa njolla, lejohen plasaritje te lehta ne siperfaqe. Ne prerje eshte e njellojte , e paster pa lende te huaja dhe me ngjyre te bardhe deri ne krem.
<u>Forma</u>	Prizem trekendesh me nje faqe anesore cilindrike
<u>Shija dhe era</u>	E kendeshme , specifike e djathit te bute , te stazhionuar , pa shije te hidhur e djegese dhe pa ere e shije te huaj .
<u>Struktura dhe konsistenca</u>	E lemuar , e bute dhe pa dallim shtresash

TREGUESIT FIZIKE – KIMIKE

Lageshtia ne perqindje jo me shume se : Per periudhen 1.05 deri ne 30.09 52

Per periudhen 1.10 deri ne 30.04 56.

Yndyra

Ne lendet e thata ne perqindje jo me pak se 50

Permbajtja e kripes

Duhet te jete 4 ± 1 .

Te gjithe treguesit e mesiperm jane per cilesine e pare , baxhoje te stazhionuar i prodhuar me qumesht lope .

GJALP I FRESKET - Bazuar ne STAZH 1445\87

Treguesit shqisorë:

1.Pamja:

E njëtrajtshme, pa shtresa, në prerje e sipërfaqe të shënditura pa pika uji dhe mbeturina dhalli.

2.Ngjyra:

Krem deri në të verdhë të çelur.

3.Era dhe shija:

E këndshme, karakteristike e gjalpit të freskët pa erë dhe shije të huaj.

Treguesit kimik:

Lageshtira në % ,jo me shumë se 17.

Lëndët e thatë pa yndyr në e %, jo më shumë se 2.

Yndyra në %, jo më pak se 81 gjalpi i freskët dhe 79 gjalpi i kripur.

Kripë në %, jo më shumë se 2 gjalpi i kripur.

Ngarkesa mikrobike brenda normave të lejuara nga Ministria e Shendetesise.

Amballazhimi:

Ambalazhohet në kuti kartoni të valëzuar me masë 1- 5 kg, të veshur nga brenda me letër pergamen.

Mbi çdo ambalazh me gjalpë vendoset etiketa në të cilën shënohen:

Emërtimi i prodhuesit

Emri i produktit

Pesha neto ose vëllimi i produktit

Data e prodhimit

Kushtet e veçanta të ruajtjes

Rekomandime për përdorim, nëse këto ndikojnë në mënyrë të ndjeshme mbi afatet e ruajtjes së cilësisë ose mbi vlerat e produktit ushqimorë.këto të dhëna të jepen mbi ambalazh ose mbi etiketë.Etiketa e produktit të ambalazhuar duhet të fiksohet në menyrë që të mos shkëputet nga ambalazhi.

Shënimet e detyrueshme të marketimit duhet të jenë të qarta, të dukshme mire, të pashlyeshme dhe lehtësisht të lexueshme në kushtet normale të blerjes dhe përdorimit.

N.q.se është i mbuluar me një material veshës të gjitha informacionet e detyrueshme duhet të figurojnë mbi këtë të fundit ose etiketa e ambalazhit duhet të jetë lehtësisht e lexueshme dhe jo e maskuar nga ambalazhi.

Emri i produktit ushqimor dhe përmbajtja neto duhet të bjerë në sy që në pamje të parë.

N.q.se gjuha në etiketën origjinale nuk është e pranueshme për konsumatorin për të cilin ajo është e destinuar duhet të përdoret nje etiketë shtesë që përmban informacionin e detyrueshëm në gjuhën shqipe.

Në rastin kur etiketa është zëvendësuar, apo plotësuar me një tjetër shënimet e detyrueshme duhet të jene pikë për pikë si të etiketës orgjinale.

Malli të shoqërohet me fletë analize laboratorike, çertifikatë orgjine.

Ruajtja dhe transportimi:

Gjalpi ruhet në frigorifer në temperaturë 2-4 °C,

Transportimi i gjalpit nga një rreth në tjetrin bëhet me mjete frigoriferike. Transportimi bëhet me mjet të mbuluar e të pastër, i cili është i destinuar për transportimin e prodhimeve ushqimore.

Për Lotin Nr.3 “Blerje Mishi”

Oferta që do të paraqitet nga secili konkurent duhet të përfshijë :

Furnizimi për artikullin e mesiperm do të jetë vetëm **MISH VICI CIL.PARE**

KERKESAT CILESORE

Cilesia e pare. Muskulatura është e zhvilluar mirë . Kockat nuk duken. Në vijaçat e vegjel mund të duken pak. Zgavra e legenit është e mbuluar me dhjame dhe veshkat janë të mbuluara me dhjame , në jo më pak se 80 % të sipërfaqes.

Pamja e jashtme . Sipërfaqja e mishit është e mbuluar me një cipë të hollë tharje.

Sipërfaqja e mishit pas prerjes është e lagët dhe e ndritshme.

Sipërfaqja e mishit në prerje është e lagët dhe e ndritshme, lëngu del me veshitësi dhe është i tejdukshëm.

Ngjyra.

Në sipërfaqe ka ngjyrë rozë në të kuqe . Ngjyra e dhjames në mishin e vicit është e bardhë.

Konsistenca

E butë dhe elastike. Gjurma që formohet kur mishi shtypet me gisht zhduket menjëherë.

Era

E këndshme , nuk ka erë të llojit .

Palca e kockave

Mbush të gjithë kanalën e palcës së kockave, ngjyra është e verdhë.

Lëngu i mishit pas zierjes

I tejdukshëm, aromatik , në sipërfaqe duken shtresa ose pika yndyre.

Furnizimi me mish do të bëhet me trup të plotë ose gjysma trupi .

Trupi ndahet në gjysma në mes të vertebërave të shtyllës kurrizore , duke lënë në njërin anë palcën e kurrizit. Organet e brendshme vecohen.

Cdo parti e furnizuar (trup ose gjysëm trupi) duhet të mbajë vulën e veterinerit të zonës ku tregtohet.

Furnizimi me mish do të bëhet cdo 2-3 ditë

Për Lotin Nr.4 “Blerje Fruta Perime”

Patate : Kërkohet cilësi e parë, të jetë e plotë ,të forta ,të pastra e të thata ,jo jeshile ,jot e mbira , me ngjyrë dhe me sytha . Kokrra të jetë e pjekur . Madhësia e kokrrës të jetë për patatën dimërore mbi mbi 5 cm dhe për veroren mbi 4 cm.Nuk lejohen të gjelbërta Nuk lejohen të gjelbëra, të vyshkura, të mbira, të çara e të prera, të kalbura, njolla bojë hiri e ndryshku, dëmtime nga krimbi, dëmtime nga dosa dhe të papastruara nga dherat. Duhet të jenë të

amballazhuara në thasë rrjete 25 deri në 30 kg.

Qepë e thatë : Kërkohet cilësia e pare, të jetë m pjekuri të plotë, me cipë e bisht të thatë, të shëndosha e të plota, me ngjyrë e formë tipike të kultivarit. Madhësia e kokrrës për ovalet të jetë nga 48 cm dhe për llojet e tjera 5-10 cm. Lejohen jo më shumë se 1 % e partisë me dëmtime të lehta dhe 1 % lënde të huaja. Me sëmundje nuk lejohen. Të ngrira, të kalbura e të mykura nuk lejohen.

Preshi : Kërkohet cilësia e pare, të jetë i fresket, i njome, i paster, me gjyre të bardhë e jeshile, i pa vyshkur dhe i lare me uje të pijshem. Diametri në pjesën me të trase të jetë mbi 2.5-3.5 cm. Gjatesia e kercellit të jetë 25-45 cm. Gjatesia e gjethit nga rozeta të jetë jo më shumë se 20 cm. Sistemi rrenjor të jetë jo më shumë se 1 cm. Dëmtime e sëmundje nuk lejohen.

Laker : Kërkohet cilësia e pare, të jenë të zhvilluara, me mbështjellje fletesh, e forte në prekje. Lejohen lakra të pa ngjeshura deri në 5 % të partisë. Të jenë të pastra dhe me 2-3 gjethe të gjelbra, të lidhura me koçanin i cili tejte deri në 3 cm. Lejohen deri në 5 % e partisë me dëmtime të lehta mekanike, të çara lehtësisht e të shperthyera si dhe të demtuara lehtësisht nga bryma. Me sëmundje nuk lejohen. Peshë e kokrrës të jetë jo më pak se 1 kg për lakren e hershme dhe për pjekje të mesme e të vona jo më pak se 1.5 kg.

Domate: Kërkohet domate e cilësise së pare, ku të jenë të fresketa, me formë tipike të kultivarit, të plota, të pastra, të pa vrara, të pa shtypura, pa kalbje dhe pa njolla nga diegja e diellit, të pa prekura nga sëmundjet dhe demtuesit si dhe të pa lagura. Pjekuria duhet të jetë normale, me ngjyre të kuqe, lehtësisht rozë dhe jeshile rreth bishtit. Nuk lejohen domate të tejpkjura, të zbutura e të vyshkura. Dëmtime e sëmundje nuk lejohen. Të plasura e të vrara lehtësisht për llojet e mesme e të vona lejohet deri në 5 % plasaritje rreth bishtit, por pa rrjedhje lëngu. Madhësia e kokrrës të jetë: Për të hershmet 3-4 cm. Për të mesmet e të vonat 7 cm.

Specë : Kërkohet cilësia e pare, të jenë me formë e ngjyre të kultivarit, të fresketa, të pastra dhe me pjekuri natyrale. Lejohen dëmtime jo më shumë se 3 %. Shija të jetë karakteristike e kultivarit. Lejohet shije djegese e lehtë. Nuk lejohet perzierja e specave djeges me ato jo djeges. Gjatesia të jetë për të gjatat mbi 10 cm dhe për të rrumbullaktat mbi 7 cm.

Patllixhan : kërkohet cilësia e pare, të jenë të fresket, të paster, me sipërfaqje të lemuar, me ngjyre të zeze në manushaqe, me pjekuri normale, me flete jeshile me nuanca të dobëta manushaqe, të pa vyshkura. Dëmtime të ndryshme e sëmundje nuk lejohen. Për të gjatat kërkohet diametri jo më shumë se 5 cm dhe gjatesia 15-20 cm. Gjatesia e bishtit të jetë jo më shumë se 4 cm.

Tranguj : Bazuar në STASH 1754\88

Treguesit cilësorë të kastravecit:

1. Pamja e jashtme:

Të freskët me ngjyrë e formë tipike të kultivarit, me përkulje të lehtë.

1. Përbërja e brendshme e tulit:

Me tul të fortë e të lëngshëm. Farat e pa zhvilluara e pa kore të fortë.

2. Madhësitë:

Gjerësia (diametrik me i madh) deri në 5 cm, Gjatësia në cm nuk kërkohet.

Dëmtime mekanike (gërvishtje të lehta në lekura) në % jo më shumë se 2.

3. Të prekura nga insektet, të kalbura:

Nuk lejohen.

Bishtaja: Bazuar në STASH 1491 –88

Treguesit cilësorë:

1.Pamja e jashtme

Të freskëta, të shëndosha të pastra, me fije normale për kultivarin dhe me fara që duken lehtë, me formë të drejtë, lehtësisht të deformuara. Me formë prizmi shumëkëndësh që ngushtohet në majë, të padrunjzuara e pa fije.

Gjatësia në cm

Barbunja frutshkurtër deri 6 cm

Barbunja frutgjatë deri 8 cm

Dëmtime të ndryshme (mekanike, sëmundje nga kimikatet)


Lejohet deri në 5% të partisë me vyshkje të lehtë. Nuk lejohen me sëmundje e dëmtues.

Ngjyra

Tipike për kultivarin. Lejohen deri në 5% të masës me ngjyrë tjetër, me përjashtim të ngjyrës së zezë.

Ndërtimi i frutit

Fruta të butë me fara të vogla në fazën e qumështit. Lejohen me fruta jo të pjekura deri në 2% të masës.



Bamje: Kerkohen te jene te fresketa, te shendosha, te pastra, me fije normale per kultivarin dhe fara qe duket lehte, me forme te drejte, lehtesisht te deformuar. Forma te jete e nje prizmi shumekendesh qe ngushtohet ne maje, te pa drunjezuara e pa fije. Gjatesia e cilesise se pare per bamjen frutshkurter te jete deri ne 6 cm dhe per ate frutgjate te jete deri ne 8 cm. Lejohet deri ne 5 % te partise me vyshkje te lehte. Nuk lejohet me semundje e demtues. Ngjyra te jete tipike per kultivarin. Fruti te jete i bute, me fara te vogla ne fazen e qumeshtit. Lejohet me fruta te tejpjekura deri ne masen 2% per cilesine e pare.

Fasule: Cilesi e pare, jo inporti, te bardha, te painfektuara nga insektet, jo te thermuara, ambalazhi 1 kg.

Molle: Kerkohet cilesia e pare, me forme, ngjyre e shije te kultivarit, pa deformime, me pjekuri teknike te njejte, te shendosha, te pastra, te zhvilluara normalisht, pa ere e shije te huaja. Lejohen edhe kokrra pa bisht,por pa difekte rreth bishtit. Madhesia e kokrrs te jete jo me pak se 60 mm ne prerje ne gjatesi. Demtime te ndryshme mekanike lejohen deri ne dy njolla jo te zeza,te vogla,te lehta per kokerr. Nuk lejohen te kimbura. Njolla te shkaktuara nga dielli ne lekurenuk

lejohen. Gunga, njolla ne lekure nuk lejohen. Njolla nga solucionet kimike ne siperfaqen e kokrres lejohet deri ne $\frac{1}{4}$ e siperfaqes se frutit.

Portokalla te fresket cilesia e I-re

Kopkra te jete cilesia e pare,te fresket,me zhvillim normal te shendetshem e me bisht,mbas 15 janarit kokrat lejohen pa bisht.Me pjekuri teknike te plote .Ngjyra te jete e verdhe ne portokall. Me ere karakteristike e shije te embel. Dhe te athet pa shije te hidhur. Madhesia e kokres jo me a madhe se 70 mm.,demitet mekanike nuk lejohen .te prekurat nga semundjet e insektet nuk lejohen ,kokrat e zbutura te gervishtura te ngrira nuk lejohen.

a- Furnitori apo transportuesi te pajiset me autorizim dhe me te drejt firme kur nuk zbatohen kushte e vendosura nga institucioni.

b.Furnizimi me perime do te kryehet sipas kerkeses apo grafikut te hartuar per kete qellim.

c.Kur nuk zbatohen kushtet e mesiperme dhe me 3 proces-verbale gjate vitit do te nderprite furnizimi me firmen kontraktues.

d. Furnizimi do te behet 3 (tre) dite ne jave.

Për Lotin Nr. 5 . “Blerje Buke”

1- Buka te jete me rreze mielli 75-80

2- Buka te jete e prodhuar brenda dites dhe te jete i garantuar brenda standarteve shterore

3- Buka te jete e prere dhe e futur ne qese plasmasi dhe te shoqerohet me flete analize .

4- Furnitori apo transportuesi te pajiset me autorizim dhe me te drejt firme kur nuk zbatohen kushte e vendosura nga institucioni.

5. Furnizimi me Buke do te kryhet cdo dite.

6. Kur nuk zbatohen kushtet e mesiperme dhe me 3 proces-verbale gjate vitit do te nderprite furnizimi me firmen kontraktues.

7. Buka ne cdo raste furnizimi te jete me kallop 1 Kg pa demtuar ciulesin, permasat, teknologjin, amballazhimin.

Per plotesimin e treguesve te mesiperm do te kete kontrolle me te shpeshta nga Drejtoria e Sherbimit Spitalore.

Shtojca 10

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

SASIA DHE GRAFIKU I LËVRIMIT

Sasia e mallit që kërkohet: **Sipas Nevojave të Drejtorisë së Shërbimit Spitalor Mat**

Për Lotin Nr.1 : “Blerje Ushqimore”

1	2	3	4	5	6
Nr	Përshkrimi i mallrave	Sasia	Çmimi Njësi	Çmimi Total	Afati 31.12.2018
1	Vaj	650 kg			
2	Sheqer	400 kg			
3	Oriz	950 kg			
4	Makarona	800 kg			
5	Veze	4400 kokrra			
6	Salce	175 kuti			
7	Kripe	130 pako			
8	Recel	30 kg			
9	Miell gruri	130 kg			
10	Caj	28 kg			
11	Uthull	100 lit			
12	Vaj ulliri	40 lit			
13	Niseshte	100 kg			
14	Vegete	10 kuti			
15	Biskota	25 kg			
16	Rigon	2 kg			
	Çmimi Neto)				
	TVSH (%)				
	Çmimi Total				

Për Lotin Nr.2 “Blerje Bulmeti”

Nr	Përshkrimi i mallrave	Sasia	Çmimi Njësi	Çmimi Total	Afati 31.12.2018
1	Qumesht	4000 litra			
2	Djath	650 kg			
3	Gjalp	45 kg			
	Çmimi Neto)				
	TVSH (%)				
	Çmimi Total				

Për Lotin Nr.3 “Blerje Mishi”,

Nr	Përshkrimi i mallrave	Sasia	Çmimi	Çmimi	Afati
----	-----------------------	-------	-------	-------	-------

Dokumentat Standarde të Tenderit

			Njësi	Total	31.12.2018
1	Blerje mish vici	450 kg			
	Çmimi Neto)				
	TVSH (%)				
	Çmimi Total				

Për Lotin Nr. 4 “Blerje Fruta Perime”


Nr	Përshkrimi i mallrave	Sasia	Çmimi Njësi	Çmimi Total	Afati 31.12.2018
1	Patate	1200 kg			
2	Qepe e thate	980 kg			
3	Fasule	90 kg			
4	Presh	100 kg			
5	Laker	140 kg			
6	Domate	200 kg			
7	Speca	100 kg			
8	Patellixhan	100 kg			
9	Tranguj	70 kg			
10	Bishtaja	40 kg			
11	Bamje	40 kg			
12	Molle	40 kg			
13	Portokalle	40 kg			
	Çmimi Neto)				
	TVSH (%)				
	Çmimi Total				

Për Lotin Nr.5 “Blerje Buke”,

Nr	Përshkrimi i mallrave	Sasia	Çmimi Njësi	Çmimi Total	Afati 31.12.2018
1	Buke gruri	5000 kg			
	Çmimi Neto)				
	TVSH (%)				
	Çmimi Total				

Afatet e lëvrimit: **Levrimi i mallrave do te behet nga data e lidhjes se kontrates deri me 31.12.2018 dhe sipas kerkesave te Autoritetit Kontraktor ne magazinën e Drejtorise se Sherbimit Spitalore MAT me mjetet e furnizuesit.**

Afatet e lëvrim:




Shtojca 11

[*Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në Marrëveshjen Kuadër*]

**PLANIFIKIMI I
KONTRATAVE NË MARRËVESHJEN KUADËR**

Dokumentat Standarde të Tenderit

Mall: Numri total i kontratave sipas Marrëveshjes Kuadër		
Kontrata Nr.	Titulli i Kontratës	Përshkrim i shkurtër i kontratës
01		
02		
03		
...		



Shtojca 12

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

NJOFTIM STANDARD PËR OFERTUESIN E SKUALIFIKUAR¹

[vendi dhe data]

[emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

[Adresa e ofertuesit]

I/E Nderuar, Z/Zj. <emri i kontaktit>

Ju falenderoj për pjesëmarrjen në procedurën e lartpërmendur të prokurimit publik. Procedura e kryer në përputhje me Ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006, Për Prokurimet Publike.

Oferta juaj u vlerësua me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e ofertës. Me keqardhje ju informoj se u s'kualifikuat sepse oferta e dorëzuar nga ju u refuzua për shkak të arsyes (-ve) së/të mëposhtme:

Nëse mendoni se Autoriteti Kontraktor ka shkelur LPP ose RrPP gjatë procedurës së prokurimit publik, atëherë keni të drejtë të filloni një procedurë rishikimi siç parashikohet në Kreun VII të LPP-së.

Edhe pse nuk mundëm të përdornim shërbimet tuaja në këtë rast, besoj se do të vazhdoni të jeni i interesuar në nismat tona të prokurimit.

Me respekt
< Emri >

Shtojca 13

[Shtojcë për tu plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

[Data]

Dokumentat Standarde të Tenderit

Për: *[Emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues]*

Procedura e prokurimit:

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[Sasia ose qëllimi dhe kohëzgjatja e kontratës]*

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike *[Data]* *[Numri]*

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Vlera _____
(me numra dhe fjalë)

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Vlera _____
(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë *[emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues]* se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej *[shuma përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra]*/pikët totale të marra *[_____]* është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë *[emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit]* sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda _____ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.


Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej *[vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra]*, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Ankesa: ka ose jo _____

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

[Titullari i autoritetit kontraktor]



Shtojca 14

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në rastin e marrëveshjes kuadër]

FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË MARRËVESHJEN KUADËR

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e operatorëve ekonomikë të shpallur fitues]

1. _____
2. _____
3. _____

* * *

Procedura e prokurimit:

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[Sasia, objekti , kohëzgjatja e kontratës etj]*

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë me vlerat përkatëse të ofruara:

1. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera _____

(me numra dhe fjalë)

2. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera _____

(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhëm:

1. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

2. _____

Dokumentat Standarde të Tenderit

Emri i plotë i shoqërisë _____ numri i NIPT-it _____

Perkatësisht për arsyet e mëposhtme:

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se janë identifikuar si operatorë ekonomikë të suksesshëm:

1. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera _____ / Pikët totale të marra _____

(me numra dhe fjalë)

2. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera _____ / Pikët totale të marra _____

(me numra dhe fjalë)

Etj. _____



Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë [emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit], brenda _____ ditëve nga data e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft marreveshjen.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Ankesa: ka ose jo _____

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

[Titullari i autoritetit kontraktor]

KUSHTET E PËRGJITHSHME

Mallrat –Kërkesë për propozim

Neni 1: Qëllimi

- 1.1 Këto kushte të përgjithshme të kontratës (KPK) do të zbatohen për blerjen e Mallrave të prokuruar me anë të procedurës me negociim.
- 1.2 Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Shqipërisë parashikon se dispozitat e Kodit Civil Shqiptar do të zbatohen për kontratat e prokurimit publik. Disa dispozita të Kodit Civil janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e kushteve të kontratës. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Kodit Civil të kësaj kontrate.
- 1.3 Në mënyrë të ngjashme, disa dispozita të Ligjit mbi Prokurimin Publik janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e ligjit që rregullon prokurimin publik. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Ligjit mbi Prokurimin Publik mbi të drejtat, detyrat dhe detyrimet e palëve.
- 1.4 KPK do të zbatohen deri në atë masë që të mos lënë mënjane kushtet ose dispozitat e paraqitura në pjesë të tjera të kontratës.
- 1.5 Kushtet e kontratës përfshijnë gjithashtu Kushtet e Veçanta të Kontratës (KVK). Në rast se ka një konflikt midis KPK dhe KVK, KVK do të mbizotërojnë mbi KPK.

Neni 2: Përkufizime

- 2.1 “kontratë” do të thotë marrëveshja e shkruar e lidhur midis Autoritetit Kontraktor dhe Kontraktuesit që përbëhet nga Dokumentat e Tenderit duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha shtojcat dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.
- 2.2 “çmim kontrate” do të thotë çmimi që i paguhet Kontraktuesit sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontraktore.
- 2.3 “Incoterms” do të thotë termat ndërkombëtare tregtare që përbëjnë rregullat e interpretimit të termave tregtare që përcaktojnë detyrimet përkatëse, kostot, dhe risqet e lidhura me transferimin e Mallrave nga shitësi tek blerësi.
- 2.4 “Lëvrimi” do të thotë të gjitha aktivitetet dhe veprimet që mundësojnë marrjen e Mallrave në vendin e shpërndarjes siç specifikohet në kontratë si paketimi, transportimi, sigurimi, tarifat, procedura doganore, ngarkimi dhe shkarkimi, instalimi, mbledhja, bashkimi, kontrollimi i veprimeve dhe mbikëqyrja e gjithë kësaj veprimtarie.
- 2.5 “Autoriteti Kontraktor” do të thotë Autoriteti Kontraktor që është pjesë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate blen Mallrat. Ky term kudo që përdoret ka kuptim të njëjtë me atë të perkufizuar në ligj.

- 2.6 “Kontraktues” do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate furnizon Mallrat.
- 2.7 “Palë (t)” do të thotë nënshkruesit e kontratës.
- 2.8 “Mallrat” do të thotë materialet e papërpunuara, produktet, makineritë dhe pajisjet, objektet në formë të ngurtë, të lëngshme ose të gaztë.
- 2.9 “Shërbimet e lidhura me to” do të thotë shërbimet ndihmëse ose të paparashikuara të furnizimit të Mallrave, si transportimi, instalimi, mirëmbajtja, trajnimi, shërbimet mbështetëse ose detyrime të ngjashme në lidhje me furnizimin e Mallrave.
- 2.10 “Objekt i kontratës” do të thotë të gjitha Mallrat dhe Shërbimet e lidhura me to që Kontraktuesi do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.
- 2.11 “Standarde Teknike” do të thotë specifikimet e aprovuara nga një organ i posaçëm standardizimi për zbatimin e vazhdueshëm ose të përsëritur. Standarde të tilla përdoren si rregulla, rregullore ose përkufizim të karakteristikave për të siguruar se materialet dhe shërbimet e procesuara i përgjigjen qëllimit.

Neni 3: Hartimi i Kontratës

- 3.1 Njoftimi i ofertës fituese do të shërbejë për hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të parashikuar në Dokumentat e Tenderit.
- 3.2 Egzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës duke trupëzuar të gjitha marrveshjet midis palëve.

Neni 4: Praktikat e Korrupsionit, Konflikti i Interesit dhe Kontrolli i Procesverbaleve

- 4.1 Autoriteti Kontraktor mund t’i kërkojë gjykatës të deklarojë të paligjshme kontratën nëse zbulon se Kontraktuesi ka kryer veprime korruptive. Veprimet korruptive përfshijnë veprimet e përshkruara në Nenin 26 të Ligjit mbi Prokurimin Publik.
- 4.2 Kontraktuesi nuk duhet të ketë lidhje (të tashme ose të shkuara) me asnjë konsulent ose ndonjë ent tjetër që ka marrë pjesë në përgatitjen e Dokumentave të Tenderit për këtë prokurim.
- 4.3 Kontraktuesi duhet të lejojë Autoritetin Kontraktor të inspektojë llogaritë dhe regjistrat që kanë lidhje me zbatimin e kontratës ose t’i kontrollojë ato me anë të kontrollorëve të emëruar nga Autoriteti Kontraktor.

Neni 5: Informacioni Konfidencial

- 5.1 Kontraktuesi dhe Autoriteti Kontraktor duhet të mbajnë në konfidencë të gjitha dokumentat, të dhënat dhe informacionet e tjera të dhëna nga pala tjetër në lidhje me kontratën.
- 5.2 Kontraktuesi mund t’i japë nënkontraktuesit dokumenta të tilla, të dhëna ose informacione

të tjera që merr nga Autoriteti Kontraktor deri në masën e kërkuar për nënkontraktuesin të kryejë punën e tij sipas kontratës. Në rast të tillë, Kontraktuesi duhet të përfshijë në kontratën e tij me nën-Kontraktuesin një dispozitë që parashikon ruajtjen e konfidencialitetit siç thuhet në Paragrafin 5.1 më sipër.

Neni 6: Pronësia Intelktuale

- 6.1 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruara nga Kontraktuesi gjatë zbatimit të kontratës do t'i përkasin Autoritetin Kontraktor i cili mund t'i përdorë ato sipas gjykimit të tij.
- 6.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, Kontraktuesi, pas përfundimit të kontratës, duhet t'i parashtrijë Autoriteti Kontraktor të gjitha raportet dhe të dhënat si hartat, diagramet, skicimet, specifikimet, planet, statistikave, llogaritjet dhe regjistrat mbështetës ose materialet e fituara, mbledhura ose përgatitura nga Kontraktuesi gjatë zbatimit të kontratës. Kontraktuesi mund të mbajë kopje të këtyre dokumentave dhe të dhënave, por nuk duhet t'i përdorë për qëllime që s'kanë lidhje me kontratën pa leje paraprake me shkrim nga Autoriteti Kontraktor.
- 6.3 Kontraktuesi duhet të shkarkojë Autoritetin Kontraktor nga përgjegjësia për shkelje të të drejtave të pronësisë intelektuale që mund të dalin nga prodhimi ose shpërndarja e Mallrave sipas kontratës.
- 6.4 Në rast se ngrihet ndonjë pretendim ose padi kundër Autoritetit Kontraktor në lidhje me ndonjë shkelje të pronësisë intelektuale të shkaktuar nga zbatimi i kontratës ose nga përdorimi i Mallrave të furnizuara sipas kontratës, Kontraktuesi duhet t'i japë Autoritetit Kontraktor të gjitha provat dhe informacionin në posedim të Kontraktuesit që kanë të bëjnë me këtë padi apo pretendim.

Neni 7: Origjina e Mallrave

- 7.1 Nuk ka asnjë kufizim për kombësinë e origjinës së mallrave, përveç atyre që mund të jenë përcaktuar në ndonjë Rezolutë të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara.
- 7.2 Kontraktuesi mund të jetë i detyruar të verifikojë origjinën e mallrave.
- 7.3 Për qëllime verifikimi, "origjinë" do të thotë vendi ku mallrat janë nxjerrë, ose prodhuar. Mallrat janë prodhuar kur, nëpërmjet përpunimit, procesimit, ose mbledhjes së mjaftueshme të komponentëve, rezulton një produkt i ri i njohur në tregti që është mjaft i ndryshëm në karakteristikat bazë ose në qëllim apo përdorim nga komponentët e tij.
- 7.4 Origjina e mallrave ka dallim nga kombësia e Kontraktuesit ose nënkontraktuesit që siguron mallrat.

Neni 8: Qëllimi i Furnizimit dhe Përshtatshmëria e Mallrave me Specifikimet

- 8.1 Kontraktuesi duhet të dorëzojë Mallrat në përputhje me cilësinë, sasinë dhe llojin e specifikuar në kontratë, si dhe të vendosura dhe paketuara në mënyrën e përcaktuar në kontratë.

- 8.2 Mallrat nuk janë në përputhje me kontratën, nëse ato nuk janë të përshtatshme për përdorimin e posaçëm të parashikuar në kontratë. Kur nuk është e mundur të përcaktohet një gjë e tillë, thuhet se Mallrat nuk janë në përputhje me kontratën nëse ato nuk janë të përshtatshme për përdorimin për të cilin shërbejnë zakonisht sendet e tjera të të njëjtit lloj.
- 8.3 Nëse shitja është bërë në bazë të një modeli ose kampioni, shitësi (Kontraktuesi) duhet të dorëzojë sendet që kanë të njëjtat cilësi si të modelit ose kampionit.

Neni 9: Përputhshmëria e Mallrave me Standardet Teknike

- 9.1 Mallrat e furnizuara sipas kontratës duhet të jenë konform kodeve dhe Standardeve Teknike të parashikuara në specifikimet teknike. Nëse gjatë ekzekutimit të kontratës, ka ndryshime në kodet përkatëse ose në Standardet Teknike, këto ndryshime do të zbatohen vetëm pas aprovimit nga Autoriteti Kontraktor.
- 9.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet nga ndonjë dispozite tjetër e kontratës, kur nuk është përcaktuar asnjë Standard Teknik përkatës në specifikimet teknike, Mallrat duhet të jenë konform Standardeve Teknike ndërkombëtare. Nëse nuk ekzistojnë Standarde Teknike ndërkombëtare, Mallrat duhet të jenë konform Standardeve Teknike përkatëse Shqiptare.
